



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 568 Prot.

Tiranë, 28.01 2020

VENDIM

Nr. 1 datë 29.01 2020

***Për miratimin e grupit të punës për hartimin e Draft-Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Tiranës”***

Bazuar në nenin 38, pika 1, gërma *d* dhe nenin 131, pika 2 të Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në nenin 31 të Statutit të Universitetit të Tiranës, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, në mbledhjen e tij të datës 28.01 2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e grupit të punës për hartimin e draft-rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Tiranës”, me përbërje si më poshtë:
  - Majlinda Keta
  - Bernard Dosti
  - Ardian Doka
  - Eglantina Gishti
  - Orion Muçollari
  - Gledian Caka
  - Eno Lushka
2. Grupi i punës duhet të hartojë draft-rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Tiranës” në përputhje me nenin 131, pika 2 të Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Statutin e Universitetit të Tiranës.
3. Brenda datës **5 Shkurt 2020** grupi i punës duhet të përcjellë zyrtarisht draft-rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Tiranës”.
4. Mbledhja e Senatit Akademik të UT-ës për miratimin e rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Tiranës” do të zhvillohet në datën **10 shkurt 2020, ora 11:00**.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

